REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: AMMK
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 8481/25
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 07
Data / Datum / Date: 19.11.25
PRISHTINË / A

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastrucure***

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS | KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE | KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | **137/AMMK/2025** | | | | |
| **DAT Ë:** | **19.11.2025** | | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | **Z. Hysen Durmishi,** UD Ministër i MMPHI | | | | |
| CC: | **Z. Edmir Sejdiu,** Zv. Drejtor i Departamentit për Reformën e Administratës Publike, Departamenti i Reformës / MPB<br>**Sekretariatin Koordinues të Qeverisë së RKS**<br>**Divizionin për Komunikim me Publikun në MMPHI**<br>Drejtorisë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit/Divizioni i Planeve, Raportimit dhe Projekteve në AMMK | | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | **Afrim Berisha, U.D.Drejtor Ekzekutiv i AMMK-së**<br>**Bajram Kafexholli, Drejtor i DMM/MMPHI** | | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Plani i Performancës së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026 i dakorduar me Njësinë Përgjegjëse** | | | | |
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | **Kati i XV**<br>**Nr. 1504** | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** | Ish Pallati i Mediave Rilindja | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 19.11.2025 |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | ☒ |

**I nderuari UD Ministër i MMPHI,**

Sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore kam marrë Vendimin me Nr.prot. 94/2025, te dt. 19.09.2025 për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt Planit për Përformancën e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026.

Me dt. 13.10.2025, Grupi Punues më ka dorëzuar Projekt-Planin e Performancës së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026.

Me dt. 23.10.2025 kam parashtruar Kërkesë për marrjen e pëlqimit për Planin e Performancës së AMMK për vitin 2026 tek Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht tek Z. Bajram Kafexholli, Drejtor i DMM/MMPHI.

Me dt. 04.11.2025 kemi pranuar komentet nga DMM/MMPHI, gjegjësisht nga Divizionet e Ajrit, Kimikateve dhe ai i Mbeturinave.

Në lidhje me këto komente kemi realizuar dy takime të ndara me divizionet përkatëse, i kemi diskutuar komentet e dhëna për të cilat edhe jemi dakorduar si të veprojmë. Ky proces ka përfunduar me 13.11.2025.

Konform paragrafit 6, Neni 7, Procesi i hartimit dhe dakordimit të Planit të Performancës, Ju njoftoj se sot, me dt. 19.11.2025 e kemi nënshkruar Planin e Performancës së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026 në cilësi të U.D Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtorit të DMM si Njësi Përgjegjëse të cilin e gjeni bashkangjitur.

Gjithashtu, konform paragrafit 10 të nenit 7, kërkojmë nga Divizionin për Komunikim me Publikun i MMPHI dhe nga Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit/Divizioni i Planeve, Raportimit dhe Projekteve të AMMK qe ky plan i nënshkruar dhe dakorduar të publikohet në ueb faqen e MMPHI dhe të AMMK brenda një afati një (1) javor nga dita e dakordimit të tij.

**Me respekt!**

**SHTOJCA I**

## Plani i Performancës së Agjencionit për Mbrojtën e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026

| | |
|---|---|
| **Data:** | 19.11.2025 |
| **AGJENCIA** | Agjencioni për Mbrojten e Mjedisit të Kosovës |
| **MINISTRIA PËRGJEGJËSE** | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures |
| ***Misioni i Agjencisë*** | Monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit dhe sigurimi i informacionit te duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit |

| **Objektivat** | **Treguesit** | **Vlera bazë** | **Vlera e synuar** | **Rezultatet** | **Alokimi financiar** | **Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Përmirësimi i monitorimit, vlerësimit, raportimit dhe hulumtimit te gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit | 1. Numri i vizitave të realizuara të rregullta në zonat e mbrojtura;<br>2. Numri i raporteve nga monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes, evidentimi i problemeve aktuale dhe rekomandimi i masave përkatëse;<br>3. Numri i hulumtimeve/ studimeve për zonat e reja të natyres dhe procedimi për mbrojtjen e tyre;<br>4. Numri i shenjtërimeve të zonave të mbrojtura; dhe<br>5. Monitorimi i biodiversitetit (faunës me kamera kurthe dhe llojet e rrezikuara të florës). | 30<br>17<br>1<br>20<br>10 | 35<br>20<br>2<br>25<br>15 | Krijimi i një pasqyre të qartë për gjendjen e zonave të mbrojtura.<br>Paraqitja e gjendjes, rritja e sipërfaqes dhe numrit të zonave të mbrojtura.<br>Monitorimi dhe raportimi për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin.<br>Krijimi i një pasqyre të qartë për gjendjen e biodiversitetit. | 40,000.00 €<br>20,000.00 € | Ligji për mbrojtjen e natyrës;<br>Ligji për parqet kombëtare;<br>Strategjia dhe Plani për biodiversitet. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. Mirëmbajtja, avancimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe hidrometerologjisë | 1. Numri i stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit të mirëmbajtura;<br>2. Numri i stacioneve të monitorimit hidrologjik të lumenjve të mirëmbajtura;<br>3. Numri i vend-mostrimeve në pikat e monitorimit të ujërave sipërfaqësore;<br>4. Numri i vend-mostrimeve në pikat e monitorimit të ujërave nëntokësore; dhe<br>5. Numri i stacioneve automatike meteorologjike (24) dhe stacioneve të reshjeve (39) të mirëmbajtura. | 13<br>34<br>56<br>40<br>63 | 13<br>34<br>56<br>40<br>70 | Zgjerimi i rrjetit të monitorimit duke shtuar parametra të tjerë monitorues dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e stacioneve/pajisjeve | 75.000.00 €<br>21,000.00 €<br>20,000.00 € | • Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike<br>• Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja<br>• Ligji për mbrojtjen e mjedisit<br>• Ligji për ujërat e Kosovës<br>• Programi i IHMK-së për monitorimin e gjendjes së mjedisit |
| 3. Parandalimi i veprimeve ilegale për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe fuqizimi me resurse humane në Parqet Kombëtare | 1. Numri i veprimeve ilegale të prerjeve të Pyjeve;<br>2. Numri i veprimeve ilegale të ndërtimeve dhe infrastrukturës përcjellëse;<br>3. Shtimi i numrit te të punësuarve me Rojtar të Natyrës, staf teknik dhe profesional; dhe<br>4. Numri i veprimeve ilegale të shfrytëzimit të kullosave dhe gjuetisë. | 70<br>160<br>3<br>10 | 40<br>120<br>15<br>5 | Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i territorit të Parqeve Kombëtare | Shtimi i projekteve dhe numri buxhetit | • Ligji për Parkun Kombtëtar "Sharri";<br>• Ligji për Parkun Kombtëtar "Bjeshkët e Nemuna";<br>• Ligji për Mbrojtjen e Natyrës;<br>• Ligji për pyjet e Kosoves<br>• Ligji për gjuetinë;<br>• Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Sharri";<br>• Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar ''Bjeshkët e Nemuna";<br>• Plani Menxhues i Parkut Kombëtar ''Bjeshkët e Nemuna'';<br>• Plani Menxhues i Parkut Kombëtar "Sharri";<br>• Rregullorja për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Përmirësimi i shërbimeve dhe promovimi i MNRV "Shpella e Gadimes" | 1. Numri i vizitorëve të pranuar dhe menaxhuar;<br>2. Shuma e të hyrave nga menaxhimi i vizitorëve;<br>3. Fushata promovuese për MNRV Shpella e Gadimes ;<br>4. Numri i aktiviteteve për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ambienteve të shpelles; dhe<br>5.Digjitalizimi i brendësisë së shpellës me kamera sigurie. | 12,000.00<br>14.000.00 €<br>0<br>3<br>0 | 12,500.00<br>15.000,00 €<br>1<br>3<br>1 | Rritja e numrit te të hyrave në MNRV "Shpella e Gadimes" | 10,000.00 €<br>20,500.00 €<br>20,000.00 € | • Ligji për mbrojten e natyres<br>• Ligji për financat publike |
| 5. Përmirësimi i raportimit dhe informimit për gjendjen e mjedisit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar | 1. Numri i raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit dhe sektorëve mjedisor të përgatitura;<br>2. Numri i raporteve të dërguara në Agjencionin Evropian të Mjedisit / EEA;<br>3. Numri i raporteve mbi zbatimin e aktiviteteve të AMMK;<br>4. Numri i informative dhe aktivitete te publikuara në ueb faqen dhe rrjete sociale e AMMK;<br>5. Mirëmbajtja e ueb aplikacioneve RKMRR dhe ARVM; dhe<br>6. Krijimi i WEB Aplikacionit të SIM ueb Aplikacionit. | 4<br>6<br>9<br>40<br>2<br>0 | 5<br>7<br>10<br>45<br>2<br>1 | Publikimi i tyre, informimi për gjendjen e mjedisit për publikun dhe rekomandimi për vendimarrësit | 10,000.00 €<br>40,000.00 €<br>70,000.00 € | Ligji për mbrojtjen e mjedisit,<br>Ligji për mbeturinat<br>Ligji për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja<br>Ligji për veprimtaritë hidrometerologjike<br>Programi për menaxhimin e SIM<br>UA për SIM |

AFRIM BERISHA

UD. Drejtori i Ekzekutiv i AMMK

Bajram Kafexholli

Njësia Përgjegjëse

**Pjesa përshkruese e Planit Vjetor të Përformancës së Agjencionit për Mbrojten e Mjedisit të Kosovës për vitin 2026**

Pjesa përshkruese është e bazuar në Nenin 9 – Forma dhe përmbajtja e Planit Vjetor të Përformacës, te Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore ku decidivisht është përcaktuar qe në projekt Plan të adresohen edhe:

*1. **Hulumtimi dhe monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit*** është planifikuar qe afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike për përmbushjen e objektives parashikohet të jenë: mungesa e stafit, mungesa e pajisjeve te terrenit, mungesa e hapësirës / zyreve te IKMN, dhe veturat e terrenit;
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i përformancës;
- Departamenti përgjegjës për zbatimin e kësaj objektive është Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës në koordinim me komunat, universitetet, OJQ etj; dhe
- Kurse kostoja financiare dhe burimin financiar planifikohet të ndahet nga buxheti i Republikë së Kosovës.

*2. **Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe hidrometerologjik*** do të zbatohet në periudhën K1-K4.

- Sfida specifike – resuset humane, realizimi i projekteve sipas afateve,dhe vazhdimi i veprimtarisë pas përfundimit të projekteve, trajnimeve, avancimi i teknologjis, funksionimi i aplikacioneve, mirëmbajtje përmanente e stacioneve sipas sektorëve;
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Treguesi i përformancës është përdorur edhe në këtë rast sasior;
- Departamenti apo njësia përgjegjëse – Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës;
- Kostoja financiare dhe burimi financiar – buxheti i Kosovës dhe donatorët.

3. ***Parandalimi i veprimeve ilegale dhe fuqizimi me resurse humane në Parqet Kombëtare*** është planifikuar qe afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike parashikohen të jenë: mungesa e resurseve humane (rojtar të natyrës, staf teknik dhe professional), mungesa e paisjeve teknike dhe teknologjike ( aparata dixhital, kamera kurthë, dylbi, GPS, dron, vetura terreni, paisja e rojtarëve me armë, përzierja e kompetencave institucionale, harmonizimi i legjislacionit, mungesa e akteve nenligjore, trajtimi me prioritet i lëndëve në Gjykata, kalimet ilegale të kufirit, Fuqizimi i Planit menaxhuese të Produkteve Pyjore jo Drunore, bimëve mjekuese dhe aromatike;
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i përformancës;
- Kostoja financiare dhe burimi financiar është paraparë të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet.

4. ***Rritja e numrit te vizitorëve në MNRV "Shpella e Gadimes"*** është planifikuar qe afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike parashikohet të jenë mungesa e stafit profesional, trjanime të stafit, ndërtimet ilegale në tërritorin e mbrojtur te shpelles, mosshfrytëzimi në terësi i galerive të shpellës, moseksplorimi dhe moshulumtimi i nivelit të sipërm te shpellës me korridore;
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i përformancës;
- Departamenti apo njësia përgjegjëse është Drejtoria e Monumenteve Natyres me Rëndësi të Vecantë / MNRV "Shpella e Gadimes"; dhe
- Kostoja financiare dhe burimi financiar është parapare të ndahet nga buxheti i Kosovës.

5. **Përmirësimi i raportimit dhe informimit për gjendjen e mjedisit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar** edhe sipas kërkesave ligjore është paraparë të realizohet në periudhën K1-K4;

- Sfida specifike parashikohet të jenë: aprovimi i Rregullores së brendshme të AMMK dhe klasifikimi, sigurimi i të dhënave nga komunat dhe operatorët, hapja e të dhënave, mungesa e stafit profesional, motivimi i stafit dhe mbajtja ne funksion te plotë i aplikacioneve;
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i përformancës;
- Departamenti apo njësia përgjegjëse është Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me përgjegjësi me te madhe Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit dhe Instituti Hidrometeorologjik;
- Kostoja financiare dhe burimi financiar – është paraparë nga buxheti i Republikës së Kosovës.

***Hartues Grupi Punues i emëruar me Vendimin e UD. Drejtorit Ekzekutiv të AMMK me Nr.Prot.94/MMK/2025, të dt.19.09.2025:***

1. Selvije Raci Vitija, DVGJM – Kryesuese ___________________
2. Fatmir Morina, DAPK "BN" – Anëtarë ___________________
3. Adriana Pllana, MNRV "Shpella e Gadimes" – Anëtare;___________________
4. Mentor Shala, IHMK – Anëtarë; ___________________
5. Sami Behrami, IKMN - Anëtarë; ___________________

***Prishtinë,***

***Dt. 19.11.2025***